



DRAFT

**PLANI VENDOR I VEPRIMIT
PËR BARAZINË GJINORE
2025 - 2028**

Përgatitur nga Bashkia Delvinë
në kuadër të zbatimit të
Kartës Evropiane për Barazi
të grave dhe burrave në jetën vendore

Shtator , 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|-----------|
| LISTA E SHKURTIMEVE | 3 |
| I. HYRJE | 4 |
| II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL | 6 |
| III. METODOLOGJIA | 8 |
| IV. VIZIONI, FUSHAT E NDËRHJRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË | 9 |
| V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PVVBGJ 2025- 2028 | 13 |
| VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI | 16 |
| VIII. MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 - 2028 | 18 |

LISTA E SHKURTIMEVE

| | |
|--------|---|
| AGK | Aleanca e Grave Këshilltare |
| BE | Bashkimi Evropian |
| BGJ | Barazia Gjinore |
| CEDAW | Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave |
| DBNJ | Drejtoria e Burimeve Njerëzore |
| DTV | Drejtoria e Taksave Vendore |
| DSHP | Drejtoria e Shërbimeve Komunitare |
| SHS | Shërbimi Social |
| DHBGJ | Dhuna me Bazë Gjinore |
| DHF | Dhuna në Familje |
| ETN | Ekipi Teknik Ndërdisciplinar (për rastet e dhunës në familje) |
| GTN | Grupi Teknik Ndërsektorial (për rastet e abuzimit të fëmijëve) |
| KB | Këshilli Bashkiak |
| KBGJ | Komisioni për Barazinë Gjinore |
| KV | Koordinatorë/Koordinator Vendor kundër dhunës në familje |
| LGBTI+ | Persona lezbike, gej, biseksuale/ë, transgjinore/ë, transseksuale/ë, interseks dhe cilëndo persona të tjerë orientimi seksual dhe/ose shprehja e identitetit gjinor të të cilave/ëve është i ndryshëm nga heteroseksualet/ët. |
| MKR | Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| NBGJ | Nëpunëse/Nëpunës i Barazisë Gjinore |
| NJA | Njësi Administrative |
| NJVV | Njësi e Vetëqeverisjes Vendore |
| OS | Objektiv Specifik |
| PVVBGJ | Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore |
| SKBGJ | Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021-2030) |
| VKB | Vendim i Këshillit Bashkiak |

I. HYRJE

Bashkia e re përbëhet nga qyteti historik i Delvinës dhe komuna Vergo, pjesë e rrethit Delvinë. Qyteti i Delvinës ka kultivuar një histori të pasur të bashkëjetesës fetare mes myslimanëve, kristianëve dhe hebrejve në të shkuarën. Qyteti ka traditë në artizanat si dhe objekte të trashëgimisë kulturore, të cilat nuk përdoren aktualisht për turizëm.

Bashkia e Delvinës ka në territorin e saj edhe një vendburim gazi, i cili aktualisht shfrytëzohet nga një kompani koncesionare private. Banorët e qytetit kanë shqetësime për cilësinë e ujit të pijshëm në qytet. Bashkia e re e Delvinës u krijua si një bashki me popullsi të konsiderueshme të minoritetit grek. Ndryshe nga qyteti i Delvinës, komuna Vergo është një zonë e gjerë rurale me densitet të ulët të popullsisë. Bujqësia, blegtoaria dhe vreshtaria, krahas institucioneve publike janë burimet kryesore ekonomike të zonës. Papunësia është shumë e lartë dhe një pjesë e madhe e popullsisë punon në Sarandë. Largimi i popullsisë së re dhe të arsimuar ka krijuar vështirësi në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë. Nga ana tjetër, prania e shumë kulturave në qytet ofron mundësi për zhvillim, ndërsa afërsia e bashkisë së re me qytetin turistik të Sarandës ofron potencial të lartë për zhvillimin e bujqësisë.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 – 2028 u përgatit nga Bashkia Delvinë, si mjet kryesor për zbatimin e angazhimeve publike për barazinë gjinore. Ky plan veprimit u hartua përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike vendore, organizatat e shoqërisë civile, Këshillin Rinor, Aleancën e Grave Këshilltare dhe anëtare e anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj.

Drejtësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave.

Sikurse përshkruhet edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi, njësitë e vetëqeverisjes vendore janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të përparojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e aktorëve vendorë, për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave¹, të rejave dhe të rinjve², vajzave dhe djemve³. Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes vendore.

¹ “Gra dhe burra” në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshore duke filluar nga mbi 35 vjeç, deri në fund të jetës (përfshirë edhe të moshuarat/moshuarit).

² “Të reja dhe të rinj” në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 18 - 35 vjeç.

³ “Vajza dhe djem” në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 0 - 18 vjeç.

Pavarësisht ndërhyrjeve dhe përmirësimeve të vazhdueshme, me gjithë përpjekjet e bëra apo që vijojnë të bëhen ndër vite për përparimin drejt barazisë gjinore, si dhe plotësimin e harmonizimit të kuadrit ligjor dhe të politikave vendore me ato kombëtare e ndërkombëtare, duhet të pranohet që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë. Pabarazitë dhe diskriminimi apo disavantazhimi i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive por edhe ndërmjet grupeve brenda të njëjtës gjini, vijojnë të mbështeten në një sërë nocionesh shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipeve të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, komunikim, botën e punës, në organizimin e shoqërisë, etj.

Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes vendore të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikat, organizimin dhe praktikën e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin tonë ekonomik dhe shoqëror.

PVVBJGJ 2025-2028 është konceptuar dhe lidhur logjikisht me nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, me planin e mëparshëm të veprimit për barazinë gjinore⁴, përfshirë vështirësitë apo sfidat e ndeshura për zbatimin e tij, me kuadrin ligjor dhe të politikave kombëtare, si dhe instrumentat kryesorë ndërkombëtarë të ratifikuar nga shteti shqiptar lidhur me barazinë gjinore. Duke mundur gjithashtu një dokumentim sa më të mirë të rezultateve të matura me tregues të mirë përcaktuar e të ndjeshëm gjinorë. Kjo do të ndihmojë njëkohësisht edhe në mbajtjen e të dhënave të përditësuara e të ndara jo vetëm në bazë të seksit, por edhe të moshës, vendbanimit, etnisë, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual dhe shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, statusit të emigrantit / emigrantit apo azilkërkuës / azilkërkuës, në bazë të problemeve të ndryshme sociale që mund të përjetojnë, etj.

Asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson siç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve, pra të të gjithë anëtarëve dhe anëtarëve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave, të rejave e vajzave, mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore. Për të shprehur sa më qartë domosdoshmërinë e gjithë përfshirjes, në të gjithë tekstin në vijim në këtë PVVBJGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja “**nga të gjithë grupet**”, që të theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të të gjithë individëve, e në mënyrë të veçantë, të grave, të rejave dhe vajzave në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, emigrante, azilkërkuese, etj., pra nga të gjithë grupet në shoqëri.

Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura si pjesë e PVVBJGJ 2025 – 2028, janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse dhe institucionet e organizatat⁵ partnere në zbatim, afatet kohore, përgjegjësit për monitorim, si dhe kostot e nevojshme për zbatim. Këto patjetër që janë lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e

pritshme, objektivat specifike, treguesit përkatës dhe dokumentat kryesorë ku mbështeten hapat e planifikuar.

II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL

Kur flasim për kuadrin ligjor dhe të politikave në fushën e barazisë gjinore, duhet të kemi parasysh që e drejta për barazi ndërmjet gjinive buron që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 18), që është edhe dokumenti ligjor më i lartë në hierarkinë ligjore të vendit. Nën nenin 18 të kushtetutës qartësohet shprehimisht se: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit; 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore; 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.”. Kjo barazi de-jure është gjithashtu e shprehur edhe në një tërësi instrumentash ndërkombëtarë, të cilët kur ratifikohen nga Parlamenti shqiptar, zënë vend në hierarkinë ligjore të vendit menjëherë pas Kushtetutës, çfarë nënkupton që nëse për një çështje të caktuar nuk ka një parashikim të qartë në legjislacionin vendas, atëherë për zgjidhjen e saj u drejtohem parashikimeve në instrumentat ndërkombëtarë të ratifikuar.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2028 përveçse si një instrument i zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe burrave në jetën vendore, mbështetet në një tërësi dokumentash të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Shqipëri. Si më kryesoret mund të përmendim:

a) Instrumente ndërkombëtarë

- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality).
- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).
- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA).
- Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).
- Strategjia e Barazisë Gjinore 2021-2030 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2030, etj.

b) Kuadri ligjor kombëtar

- Ligji Nr. 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Ligji Nr. 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 35/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Ligji Nr. 136/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.
- Ligji Nr.104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
- Ligji Nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.
- Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- Ligji Nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin”.
- Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”.
- Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”.
- Ligji Nr. 75/2019 “Për rininë”, etj.

c) *Politikat kombëtare*

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ 2025 – 2028 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët e caktuara sipas fushave të tyre. Por politika kryesore kombëtare mbi të cilën bazohet ky PVVBGJ është Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 -2030

d) *Institucionet përgjegjëse*

Siç përshkruhet edhe në Kartën Evropiane për Barazi, përgjegjës kryesorë për zbatimin e kësaj Karte përmes përgatitjes dhe zbatimit të PVVBGJ, janë bashkitë. Në mënyrën se si është ndërtuar dhe funksionon mekanizmi kombëtar për barazinë gjinore në Shqipëri, në nivel të vetëqeverisjes vendore janë Nëpunëset/Nëpunësit e Barazisë Gjinore (NBGJ) përgjegjës për zbatimin e veprimeve në këtë drejtim, të cilat/cilët përveçse brenda institucionit të tyre raportojnë, sipas kërkesës, edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Me ngritjen e Mekanizmit të Koordinuar të referimit kundër dhunës në familje, Nëpunësja e Barazisë Gjinore ka edhe pozicionin e Koordinatorës Vendore kundër Dhunës në Familje dhe nisur nga numri i rasteve të dhunës.

Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore, në nivelin vendor luajnë edhe Aleanca e Grave Këshilltare dhe Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqenies Sociale në nivel të Këshillit Bashkiak. Po kështu me rëndësi është edhe formalizimi i një Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie i përbërë nga Drejtore/Drejtorë të Drejtorive përgjegjëse për zbatimin e këtij PVVBGJ, duke përfshirë jo vetëm ato/ata të cilat/cilët ishin edhe pjesë e grupit të punës që përgatiti këtë plan, por edhe të drejtorive të tjera sipas nevojës. Ky Komision, do të mundësonte një zbatim akoma më të mirë të PVVBGJ-së edhe për ata elementë që

nuk janë të përmendur në mënyrë të detajuar në matricë, por që siç u theksua edhe më sipër, janë të domosdoshëm për përparimin në drejtim të fuqizimit të grave, të rejeve dhe vajzave dhe arritjen e barazisë gjinore (p.sh. ky Komision do të mundësonte përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjithë dokumentat zhvillimorë të bashkisë, pavarësisht sektorit apo çështjes që mbulojnë). Ndaj dhe formalizimi i këtij Komisioni për Barazinë Gjinore në nivel bashkie është një ndër hapat e parë të parashikuar për zbatim, menjëherë pas miratimit të PVVBGJ në Këshillin Bashkiak. Në vijim, të gjithë institucionet vendore dhe OJF të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PVVBGJ, janë gjithashtu të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në përparimin drejt barazisë gjinore.

III. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PVVBGJ 2025-2028 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

- **Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues (desk review).** Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentash ekzistues apo draft dokumentash të bashkisë, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kuadrit ligjor dhe të politikave ekzistuese kombëtare e vendore, të lidhura me çështjet gjinore.

-

- **Konsultimet paraprake brenda bashkisë.** Këto konsultime u zhvilluan me stafin e bashkisë (përfaqësuese dhe përfaqësues nga të gjitha drejtoritë në bashki), si dhe administratori i NJA-së. Ky hap u konsiderua i domosdoshëm, së pari për të mundësuar njohjen me Kartën Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore për të gjitha/gjithë ata persona që nuk e kishin këtë informacion më herët (pra që mbajnë pozicione të caktuara në bashki por që nuk kanë qenë të pranishëm apo të angazhuar në procesin e njohjes me Kartën dhe përgatitjes së PVVBGJ 2025-2028), por edhe për të diskutuar mbi detaje që lidhen me formatin dhe përmbajtjen në tërësi të PVVBGJ.

- **Përgatitja e draft dokumentit të PVVBGJ 2025 – 2028.** Drafti i përgatitur për konsultim përmbante seksionet dhe të dhënat kryesore, vizionin, fushat e ndërhyrjes, objektivat specifike dhe masat e veprimet e parashikuara për arritjen e objektivave specifike. Në këtë draft u reflektuan edhe ndryshimet e dakordësuara në konsultimet paraprake brenda bashkisë.

- **Konsultime me palët e interesuara dhe grupet e interesit.** Ky proces do të zhvillohet mbi draft dokumentin e përgatitur. Në konsultim do të përfshihen drejtoritë përgjegjëse dhe stafi brenda bashkisë, NJA-së, OJF-të bashkëpunëtores, si dhe anëtare të Aleancës së Grave Këshilltare dhe të Këshillit Bashkiak. **Ky proces konsultimi do të zhvillohet përkatësisht, në datën 31 Korrik 2025 në sallën e Këshillit Bashkiak.**

- **Finalizimi i draft PVVBGJ 2025-2028 dhe kostimi i veprimeve të dakordësuara.** Finalizimi i draft PVVBGJ u bë në bazë të komenteve dhe sugjerimeve të marra gjatë konsultimit të tij. Paralelisht u realizua edhe kostimi i aktiviteteve të dakordësuara.

- **Miratimi i PVVBGJ 2025 – 2028 në Këshillin Bashkiak.** Versioni përfundimtar i PVVBGJ i konsultuar e kostuar u përcoll për miratim në Këshillin Bashkiak. Pas miratimit, PVVBGJ

2025– 2028 do të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë, si dhe versioni anglisht i tij.

Të gjitha hapat e mësipërm shkojnë në linjë dhe me metodologjinë e përgatitjes së PVVBGJ-ve siç sugjerohet nga KBRE dhe sigurisht janë aplikuar edhe gjatë përgatitjes së PVVBGJ. Megjithatë, siç u përmend edhe në hyrje të këtij dokumenti, në këtë PVVBGJ 2025– 2028 nuk janë vendosur edhe masat dhe veprimet e parashikuara në dokumenta të tjerë të bashkisë për fusha të caktuara që shkojnë në linjë me plotësimin e neneve të ndryshme të Kartës. Në vend të tyre është specifikuar dhe do insistohet të përmbushet së pari përfshirja e perspektivës gjinore në të gjithë këto plane që në momentin e përgatitjes së tyre, e së dyti do insistohet për vlerësimin e ndikimit gjinor të zbatimit të tyre, duke mundësuar kështu edhe një dokumentim e monitorim më të kujdesshëm të të gjithë veprimeve që në thelb synojnë zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi, pavarësisht nëse janë cituar apo jo ato veprime si pjesë e këtij PVVBGJ.

IV. VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Vizioni:

“Gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Delvinës, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të emigrantes/emigrantit e azilkërkueses/azilkërkuesit, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.

Parimet⁶ që udhëheqin zbatimin e PVVBGJ, janë të njëjtat parime që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, siç paraqiten në vijim:

1. Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjithë grupet, përbën një të drejtë themelore.
2. Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta.
3. Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje është parakusht për një shoqëri demokratike.
4. Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.
5. Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes vendore është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.
6. Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore.

Fushat kryesore të ndërhyrjes.

PVVBGJ 2025 – 2028 përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime specifike ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë NJVV-të. Këto fusha ndërhyrjeje janë:

⁶ Për shpjegime më të hollësishme mbi secilin parim, mund të referoheni tek teksti i Kartës Evropiane për Barazi në adresën: https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf

- I. Avancimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.
- II. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë.
- III. Avancimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm.
- IV. Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficensës së qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.

Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve, ashtu edhe për sa u përket neneve specifike të Kartës Evropiane, si dhe dokumentave të tjerë kryesorë ku mund të referohemi, në përmbushje të veprimeve të parashikuara nën secilën fushë ndërhyrjeje.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PVVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndër-institucional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, median, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PVVBGJ.

Rezultatet e pritshme, objektivat specifike dhe treguesit:

| |
|---|
| Fusha e ndërhyrjes: |
| I. Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore. |
| Rezultatet e pritshme: |
| I.a. Përgjegjshmëria dhe transparenca e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm. |
| I.b. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe perspektiva gjinore e përfshirë në politikat dhe planet e bashkisë. |
| Objektivat specifike: |

I.a. Përgjegjshmëria dhe transparencja e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.

I.b. Buxheti i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe perspektiva gjinore e përfshirë në politikat dhe planet e bashkisë.

Treguesit në nivel objektiv:

I.1.a. Numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, të publikuara në faqen e internetit të bashkisë dhe Këshillit të Bashkisë.

I.2.a. Numri i raporteve të monitorimit të shpenzimeve vjetore për programe buxhetore të caktuara, të analizuara nga këndvështrimi gjinor, të publikuara në faqen e internetit të bashkisë.

I.2.b. Numri i dokumentave të rëndësishëm vendorë të hartuar me ndjeshmëri gjinore /monitoruar nga këndvështrimi gjinor.

Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë fushë ndërhyrjeje synojnë të përmirësojnë më tej transparencën dhe llogaridhënien e Bashkisë jo vetëm kundrejt qytetareve dhe qytetarëve të saj, por edhe me institucione të tjera vendore, kombëtare e ndërkombëtare. Kjo ndikon njëkohësisht edhe tek rritja e besimit të komunitetit tek ky institucion. Përshkallëzimi i veprimeve duke kaluar në fuqizimin e strukturave të brendshme të bashkisë për të bërë analizën gjinore të buxheteve dhe vlerësimin e ndikimit gjinor të veprimeve të zbatuara, do të jenë ndihmuese edhe për një zbatim sa më të mirë të legjislacionit në fuqi lidhur me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.

Fusha e ndërhyrjes:

II. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë.

Rezultatet e pritshme:

II.a. Një brez i ri i barazisë, i krijuar, që lufton stereotipet gjinore, praktikat e dëmshme dhe diskriminimin apo disavantazhimin e shumëfishtë.

Objektivat specifikë:

II.1. Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë gjinore.

Treguesit në nivel objektiv:

II.1.a. Numri i personave të përfshirë në aktivitetet edukuese për të luftuar stereotipet gjinore, praktikat e dëmshme dhe diskriminimin apo disavantazhimin e shumëfishtë.

Masat e parashikuara nën këtë objektiv specifik synojnë të fokusohen në evidentimin e modeleve pozitive nxitëse për thyerjen e stereotipeve gjinore. Do të synohet nga njëra anë informimi dhe edukimi mbi çështjet e barazisë gjinore dhe mos diskriminimit në tërësi dhe nga ana tjetër promovimi i modeleve dhe nxitja e të rejave dhe të rinjve që të krijojnë brezin e barazisë, ku të gjithë individët në shoqëri shpalosin potencialet e tyre duke lënë mënjanë diskriminimin, disavantazhimin dhe të gjitha praktikat e dëmshme që e mbajnë familjen dhe shoqërinë larg barazisë dhe drejtësisë gjinore. Riorganizimi i punëve dhe detyrimeve brenda familjes, ku secila/secili të kujdeset për veten dhe të tjerët, duke mos ia lënë më këtë barrë vetëm gruas si “pjesë e detyrave të saj”, do të jetë gjithashtu në fokus të veprimeve të parashikuara nën këtë objektiv specifik, ku do të synohet edhe shpjegimi i aspekteve pozitive të balancimit të jetës personale me atë profesionale. Sa më sipër do të shoqërohet padyshim edhe me hapa konkretë për investimin në prindërimin pozitiv dhe komunikimin e duhur prind-fëmijë.

Fusha e ndërhyrjes:
III. Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qendrueshëm, duke shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga tranzicioni i gjelbër (mjedisor) dhe transformimi digjital.

Rezultatet e pritshme:

- III.a. Veprimet e bashkisë për të krijuar një mjedis punësimi ku harmonizohet jeta personale me atë profesionale, të rritura ndjeshëm.
- III.b. Masat që synojnë nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave, me fokus ekonominë mjedisore, të përshtatura me nevojat e tyre specifike.
- III.c. Veprimet vendore për përballimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, të parashikuara si veprime të përgjigjshme gjinore.

Objektivat specifikë:

- III.1. Përshkallëzimi i veprimeve për të sfiduar stereotipet gjinore në punësim dhe për të balancuar sipas mundësive jetën profesionale me atë personale dhe nevojën për përkujdesje për familjarët në varësi.
- III.2. Nxitja e sipërmarrjes dhe punësimit të grave e të rejave, si dhe rritja e aksesit të tyre në shërbimet e produktet financiare dhe burimet produktive.
- III.3. Nxitja e planifikimit të përgjigjshëm gjinor për përballimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.

Treguesit në nivel objektiv:

- III.1.a. Numri i personave të pajisur me informacion për luftimin e stereotipeve gjinore në punësim dhe balancimin e jetës profesionale dhe personale.
- III.2.a. Numri i grave dhe të rejave sipërmarrëse të mbështetura për përparimin drejt zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm.
- III.3.a. Numri i grave, të rejave e vajzave të pajisura me informacion për njohjen e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.
- III.3.b. Numri i planeve/dokumentave vendorë, të përgjigjshëm gjinorë, të hartuar për përballimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.

Ndër masat kryesore të parashikuara këtu evidentojmë ato që lidhen me një njohje më të mirë të legjislacionit dhe shërbimeve për nxitjen e punësimit, të cilat domosdoshmërisht çojnë në aplikimin e duhur të tyre. Informimi i të rejave dhe të rinjve mbi programet ekzistuese të nxitjes së punësimit apo mbi iniciativat mbështetëse për fillimin e aktiviteteve ekonomike, do të sjellë një rritje të interesit të tyre për të aplikuar. Po kështu, do të synohet edhe mbështetja e iniciativave që lidhen me digjitalizimin, ekonominë mjedisore, por edhe ruajtjen dhe përcjelljen e trashëgimisë kulturore.

Fusha e ndërhyrjes:
IV. Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficensës së qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.

Rezultatet e pritshme:

- IV.a. Informimi dhe elementët e sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike e private, të rritura ndjeshëm.
- IV.b. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, i fuqizuar dhe eficient.

Objektivat specifikë:

- IV.1. Përmirësimi i elementëve të sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike, si dhe rritja e informimit mbi Rezolutën 1325 “Gruaja, Paqja, Siguria”.

IV.2. Fuqizimi dhe rritja e eficensës së Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Treguesit në nivel objektiv:

IV.1.a. Numri i misionëve të auditimit të sigurisë të zhvilluara nga stafi i bashkisë në bashkëpunim me Këshillin Vendor të Sigurisë Publike.

IV.2.a. Përqindja e buxhetit të bashkisë dedikuar shërbimeve mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë fushë të ndërhyrjes synojnë përmirësimin e nivelit të sigurisë në hapësirat publike përmes koordinimit të veprimeve ndërmjet të gjithë aktorëve dhe mekanizmave përgjegjës të ngritur tashmë për këtë qëllim, si dhe rritjen e efektivitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore. Informimi dhe edukimi për të njohur më mirë të drejtat dhe mbrojtjen që ofrohet, do të shoqërohet dhe me shërbime të specializuara të cilat ofrohen sipas standardeve por edhe që mbështeten më shumë financiarisht nga bashkia. Po kështu gjetja e zgjidhjeve për të mundësuar ri-integrimin e plotë të viktimave/të mbijetuarave të dhunës në familje e të dhunës me bazë gjinore, do të jetë një tjetër drejtim në të cilin do të punohet gjatë këtyre viteve.

V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PVVBGJ 2025- 2028

Të gjitha aktivitetet e parashikuara në matricën e PVVBGJ 2025 – 2028 shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zbërthehet më tej në kosto që mbulohet nga vetë Bashkia, kosto që mbulohet si dhe kosto që ka nevojë për t'u siguruar (apo hendeku financiar).

Është e rëndësishme të theksohet se ndonëse një pjesë të mirë të aktiviteteve Bashkia e mbulon përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore e financiare (pra specialisteve / specialistëve, të cilat / cilët aktualisht marrin një page fikse, sallave / ambienteve që ka në pronësi për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, apo vënien në dispozicion të makinës dhe materialeve kancelarike të cilat blihen në total për të gjithë institucionin), etj., në këtë Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore 2025-2028 evidentohet edhe vlera përkatëse e këtij kontributi, me qëllim që gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij, të mundësohet vlerësimi edhe përmes kosto-eficencës. Është e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti që këto përlllogaritje janë bërë për minimumin e vlerave që do të kërkonte organizimi i aktiviteteve të propozuara.

Në seksionin VIII “Matrica e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2028”, për çdo masë/aktivitet të parashikuar, në kolonën e kostos jepet informacion për:

- a) **Vlerën totale të kostos të zbatimit të masës/aktivitetit.** Kjo kosto është përlllogaritur si kosto bazë (pra me zërat që përmban zbatimin e aktivitetit), e shumëzuar me numrin e aktiviteteve të parashikuara për zbatim për të gjithë kohëzgjatjen e zbatimit të PVVBGJ (pra për tre vite).
- b) **Vlerën e kostos që mbulohet nga Bashkia.** Këtu duhet pasur parasysh se kjo vlerë jo domosdoshmërisht është shtesë në buxhetin e bashkisë, ajo mund të jetë edhe në formën e angazhimit të pjesshëm të specialisteve/specialistëve të drejtorive përkatëse (pra disa ditë pune ia kushtojnë zbatimin të masës/aktivitetit, brenda pagës mujore që kanë), ose në formën e kontributit “në natyrë (in kind)” përmes vënies në dispozicion të sallave e ambienteve, etj. Po kështu, në ato raste kur masa apo veprimi është i parashikuar si detyrim parësor në një tjetër plan veprimi, në lidhje me kostot, është cituar referenca në planin përkatës, për të shmangur kështu mbivendosjet në përlllogaritjet financiare.

- c) **Hendeku financiar.** Kjo ka të bëjë me vlerën e kostos të pa mbuluar nga asnjë burim në momentin e miratimit të këtij plani. Kjo vlerë mund të mbulohet përmes negocimit me donatorët, bizneset, OJF të specializuara, etj., ose mund edhe të parashikohet brenda Planeve Buxhetore Afatmesme (PBA) e buxheteve vjetore, duke filluar nga PBA 2025-2028.

Kostot e paraqitura janë orientuese dhe miratimi i këtij Plani Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2028, të kostuar, nuk nënkupton automatikisht edhe buxhetimin e tij. Për të buxhetuar dhe alokuar fondet përkatëse të përvitshme, pa të cilat zbatimi i këtij PVVBGJ nuk merr jetë, Bashkia duhet të përfshijë në parashikimet buxhetore vjetore dhe afatmesme edhe masat e parashikuara në të. Në këtë kuadër edhe mbështetja dhe lobimi nga vetë gratë këshilltare për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve / masave, përmes përfshirjes së tyre në buxhete vjetore apo afatmesme të Bashkisë, është domosdoshmëri.

Me rishikimin e përvitshëm të Planit Vendor të Veprimit, **duhet bërë patjetër edhe rishikimi i kostove të propozuara**, bazuar edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në buxhetet vjetore apo PBA-të e Bashkisë, si dhe në marrëveshjet me donatorët apo partnerët e mundshëm. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar sidomos në periudhën e përgatitjes së PBA-ve dhe buxheteve vjetore, për të përfshirë në to masat dhe veprimet e parashikuara në matricën e PVVBGJ, sipas ndarjeve në vite.

Nga përlllogaritjet e bëra rezultojnë se kostot në tërësi për zbatimin e PVVBGJ 2025-2028 janë në vlerën **6,360,840 lekë**. Nga këto:

- **768,000 lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes I “Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore”.
- **225,000 lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes II “Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë”.
- **700,000 lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes III “Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga tranzicioni i gjelbër (mjedisor) dhe transformimi digjital”.
- **1,307,000 lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes IV “Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe efikasitetit të qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private”.

Në totalin e kostos **6,360,840 lekë** të nevojshme për zbatimin në tërësi të PVVBGJ 2025-2028 për të gjithë kohëzgjatjen e tij (tre vite):

- **3,360,840 lekë** janë kosto që do të mbulojnë nga Bashkia (me stafin ekzistues dhe me kontribut në natyrë – salla, mjete, etj.), pra të cilat nuk kanë nevojë të përlllogariten si shtesë në buxhet, sepse edhe burimet njerëzore edhe infrastrukurore ekzistojnë.

| Fushat e ndërhyrjes | Objektivat specifike | Gjithsej kosto për tre vjet | Bashkia | Donatorë të konfirmuar | Hendek financiar |
|---------------------|----------------------|-----------------------------|---------|------------------------|------------------|
| I. Përparimi në | I.1. Rritja e | 630,000lekë | 630, | 0 lekë | 0 lekë |

| | | | | | |
|--|---|------------------------------------|---------------------|-------------------------------|-------------------------|
| kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore. | përgjegjshmërisë dhe transparencës në përbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore. | | 000lekë | | |
| | I.2. Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në nivel vendor. | 138,000 lekë | 138,000 lekë | 0 lekë | 0 lekë |
| Gjithsej Fusha e ndërhyrjes I: | | 768,000 lekë | 768,000 lekë | 0 lekë | 0 lekë |
| Fushat e ndërhyrjes | Objektivat specifike | Gjithsej kosto për tre vjet | Bashkia | Donatorë të konfirmuar | Hendek financiar |
| II. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë. | II.1. Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë gjinore | 135,000 lekë | 135,000 lekë | 0 lekë | 0 lekë |
| | II.2. Investimi në prindërimin pozitiv | 90,000 lekë | 90,000 lekë | 0 lekë | 0 lekë |
| Gjithsej Fusha e ndërhyrjes II: | | 225,000 lekë | 225,000 lekë | 0 lekë | 0 lekë |
| Fushat e ndërhyrjes | Objektivat specifike | Gjithsej kosto për tre vjet | Bashkia | Donatorë të konfirmuar | Hendek financiar |
| III. Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qendrueshëm, duke shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga tranzicioni i gjelbër (mjedisor) dhe transformimi digjital. | III.1. Përshkallëzimi i veprimeve për të sfiduar stereotipet gjinore në punësim dhe për të balancuar sipas mundësive, jetën profesionale me atë personale dhe nevojën për përkujdesje për familjarët në varësi. | 500,000 lekë | 500,000lekë | 0 lekë | 0 lekë |
| | III.2. Nxitja e | 200,000 | 200,000 | 0 lekë | 0 lekë |

| | | | | | |
|--|--|------------------------------------|-----------------------|-------------------------------|-------------------------|
| | sipërmarrjes dhe punësimit të grave e të reja, si dhe rritja e aksesit të tyre në shërbimet e produktet financiare dhe burimet produktive. | lekë | lekë | | |
| Gjithsej Fusha e ndërhyrjes III: | | 700,000 lekë | 700,000 lekë | 0 lekë | 0 lekë |
| Fushat e ndërhyrjes | Objektivat specifike | Gjithsej kosto për tre vjet | Bashkia | Donatorë të konfirmuar | Hendek financiar |
| IV. Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficensës së qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private. | IV.1. Përmirësimi i elementëve të sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike, si dhe rritja e informimit mbi Rezolutën 1325 “Gruaja, Paqja, Siguria”. | 670,000 lekë | 670,000 lekë | 0 lekë | 0 lekë |
| | IV. 2. Fuqizimi dhe rritja e eficensës së qasjeve shumë-sektoriale të koordinuara kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. | 637,000 lekë | 637,000 lekë | 0 lekë | 0 lekë |
| Gjithsej Fusha e ndërhyrjes IV: | | 1,307,000 lekë | 1,307,000 lekë | 0 lekë | 0 lekë |

VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Procesi i raportimit për aktivitetet e zbatuara do të kryhet nga Drejtoria ose Sektori përgjegjës për zbatimin e aktivitetit tek *Komisioni për Barazinë Gjinore (KBGJ) i cili do të ngrihet menjëherë pas miratimit të këtij PVVBGJ në nivel të Bashkisë, me drejtuese dhe drejtues nga secila Drejtori përgjegjëse për zbatimin e PVVBGJ, në Bashki*. Menjëherë pas miratimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2028, si hap i parë i

zbatimit të tij, do të hartohen gjithashtu edhe fletët e treguesve me informacionin që duhet të mbliidhet dhe raportohet në bazë aktiviteti, por edhe në bazë të objektivave specifike. **Raportimet mbi aktivitetet** do të jenë **periodike (çdo 3 muaj)** ose në bazë të kërkesës së Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel bashkie, apo Kabinetit të Kryetarit . **Raportimet në bazë të objektivave specifike** do të përgatiten **dy herë në vit (çdo 6 muaj)**.

Monitorimi i zbatimit të Planit Vendor të Veprimit **në nivel të objektivave** do të kryhet nga **Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqenies Sociale në nivel të Këshillit Bashkiak**.

Raportet e përgatitura do të përcillen edhe tek Aleanca e Grave Këshilltare dhe sipas nevojës/kërkesës edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), por edhe në Agjencinë e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore.

Bazuar në monitorimin e kryer, PVVBGJ duhet të **rishikohet dhe përmirësohet** në mënyrë periodike dhe të paktën çdo një vit nga data e fillimit të zbatimit të tij.

VIII. MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 - 2028

| | | | | | | |
|--|--|--|--|-------------------------------|-----------------------------|---|
| Fusha e ndërhyrjes: | I. Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore. | | | | | |
| Rezultatet e pritshme: | I.a. Përgjegjshmëria dhe transparenca e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm. I.b. Buxheti i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe perspektiva gjinore e përfshirë në politikat dhe planet e bashkisë. | | | | | |
| Dokumentet kryesore që u referohemi: | <ul style="list-style-type: none"> - Karta Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality) - nenet 4, 5, 7, 8, 9. - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) - neni 3. - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA) - fusha kritike 8. - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 6, 8. - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) – shtyllat 1, 5. - Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 – 2030 – objektivi specifik IV.3. | | | | | |
| Objektivi specifik: | I.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore. | | | | | |
| Treguesi: | I.1.a. Numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, të publikuara në faqen e internetit të bashkisë dhe KBRE-së. | | | Baseline: 0 (2025) | Target: 3 (2028) | |
| MASAT DHE AKTIVITETET | TREGUESIT E REZULTATEVE | ZBATIMI | | AFATI KOHOR | SHËNIME | MONITORIMI |
| | | DREJTORIA PËRGJEGJËSE | PARTNERË DHE BASHKËPUNËTORË | | | |
| I.1.1. Përgatitja e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 – 2028 përmes një procesi konsultues e gjithëpërfshirës. | 1 draft PVVBGJ i përgatitur. | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit. | Të gjitha drejtoritë në bashki, NJA, OJF, Aleanca e Grave Këshilltare, Këshilli Rinor, Këshilli Bashkiak. | 6M II 2025 | | Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqenies Sociale (KBGJMS) në nivel Këshilli Bashkiak (KB). |
| I.1.2. Publikimi i draft Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) në faqen e internetit të bashkisë për konsultim publik, si pjesë e procesit të konsultimit gjithëpërfshirës të këtij dokumenti. | 1 link i publikimit. | Zyra e Informacionit | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit, Zyra e Informacionit | 6M II 2025 | : | KBGJMS në nivel KB. |
| I.1.3. Miratimi i PVVBGJ nga Këshilli Bashkiak. | 1 VKB për | Këshilli | Kabineti i Kryetarit, | 6M II 2025 | | KBGJMS në |

| | | | | | | |
|--|--|---|--|-------------------------------|---|---|
| | miratimin e PVVBGJ. | Bashkiak. | DSHS | 6M II 2025 | | nivel KB. |
| I.1.4. Përkthimi i PVVBGJ në gjuhën angleze dhe përgatitja e versionit për web. | 1 dokument i përkthyer dhe faqosur. | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | . | 6M I 2026 | | KBGJMS në nivel KB. |
| I.1.5. Publikimi Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) të miratuar në faqen e internetit të Bashkisë dhe Këshillit të Bashkisë | 1 Link i publikimit të PVVBGJ. | Zyra e Informacionit | Zyra e Informacionit. | 6M-I-2026 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| I.1.6. Ngritja me urdhër të Kryetares i Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel Bashkie me drejtuese dhe drejtues nga Drejtoritë përgjegjëse për zbatimin e këtij PVVBGJ. | 1 Urdhër i Kryetarit | Kabineti i Kryetarit | DSHS, organizatat ndërkombëtare. | – 6M-I-2026 | | KBGJMS në nivel KB. |
| I.1.7. Miratimi i rregullores së funksionimit të Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel Bashkie (ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë), përgjatë gjithë zbatimit të PVVBGJ. | 1 Rregullore e miratuar. | Kabineti i Kryetarit | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit. | 6M-I-2026 | | KBGJMS në nivel KB. |
| I.1.8. Përgatitja e mjeteve/formateve të unifikuara për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë, moshës, etj., për aktivitetet e zhvilluara në zbatim të këtij PVVBGJ, për t'u përdorur nga secila drejtori në bashki. | Formatet e përgatitura. | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | 6M-I-2026 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| I.1.9. Organizimi i takimeve periodike me partnerët dhe grupet e interesit mbi zbatimin e PVVBGJ dhe nevojën për përditësim të objektivave të tij. | 3 takime të organizuara (1 çdo vit). | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit. | Të gjitha drejtoritë përgjegjëse për zbatimin e PVVBGJ.. | 6M-II-2025 – 6M-II-2028 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| I.1.10. Ngritja e kapaciteteve të stafit të Bashkisë për monitorimin e zbatimit të PVVBGJ | 2 trajnime të realizuara. Nr. i mjeteve monitoruese të përgatitura. | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore | 6M-II-2025 – 6M-II-2028 | : | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| Fusha e ndërhyrjes: | II. Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficensës së qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat, si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private. | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|-------------------------------|---------------------------|---|
| Rezultatet e pritshme: | II.a. Informimi dhe elementët e sigurisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike e private, të rritura ndjeshëm. II.b. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, i fuqizuar dhe eficient. | | | | | |
| Dokumentet kryesorë që u referohemi: | <ul style="list-style-type: none"> - Karta Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore - nenet 21, 22, 23. - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË) – nenet 2/6, 6. - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA) – fusha kritike 9. - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 7, 8, 11, 13, 16, 19, 22, 23, 50, 51, 52, 53, etj. - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) – shtylla III, fusha kryesore tematike 3.1, 3.5. - Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 – 2030 – objektivat specifikë II.1, III.2. | | | | | |
| Objektivi specifik: | II.1. Përmirësimi i elementëve të sigurisë, përshtatshmërisë dhe mbrojtjes në hapësirat publike, si dhe rritja e informimit mbi Rezolutën 1325 “Gruaja, Paqja, Siguria” | | | | | |
| Treguesi: | II.1.a. Numri i misionëve të auditimit të sigurisë të zhvilluara nga stafi i bashkisë në bashkëpunim me Këshillin Vendor të Sigurisë Publike. | | | Baseline: 0 (2025) | Target: (2028) | |
| MASAT DHE AKTIVITETET | TREGUESIT E REZULTATEVE | ZBATIMI | | AFATI KOHOR | SHËNIME | MONITORIMI |
| | | DREJTORIA PËRGJEGJËSE | PARTNERË DHE BASHKËPUNËTORË | | | |
| II.1.1. Ngritja nga Bashkia e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike. | 1 KVSP e ngritur dhe funksionale | Kabineti i Kryetarit. | . Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | 6M-II-2025 – 6M-II-2028 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| II.1.2. Trajnimi i stafit të bashkisë dhe NJA-ve mbi elementët kryesorë të auditimit për sigurinë dhe përshtatshmërinë në hapësirat publike. | 1 trajnim i zhvilluar. | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | Drejtoria e Burimeve Njerëzore. | 6M-II-2025 – 6M-II-2028 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| II.1.3. Takime në NJA dhe lagje me gra, të reja, vajza, burra, të rinj dhe djem, për të diskutuar mbi nivelin e sigurisë/pasigurisë që kanë në hapësirat publike. | 5 takime të zhvilluara. | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit. | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit, MKR | 6M-II-2025 – 6M-I-2026 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| II.1.4. Adresimi në KVSP i problematikave të evidentuara mbi sigurinë në hapësirat publike. | 1 mbledhje e KVSP dedikuar mbi gjetjet nga takimet. | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | KVSP, MKR, | 6M-I-2026 – 6M-I-2027 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| II.1.5. Ngritja e grupeve audituese dhe kryerja e misionëve të auditit të sigurisë në lagje dhe në NJA. | 2 grupe auditimi të ngritura me përfaqësuese/ | Drejtoria Financës Shërbimi Social | KVSP, MKR, OJF të specializuara. | 6M-I-2026 – 6M-II-2028 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në |

| | | | | | | |
|---|--|--|---|-------------------------------|---|---|
| | përfaqësues nga të gjitha institucionet vendore, anëtare të KVSP dhe MKR, si dhe nga OJF e specializuara. 10 misione auditi të sigurisë të realizuara (5 çdo vit). | dhe Arsimit | | | | nivel KB. |
| II.1.7. Marrja në konsideratë e përmirësimit të elementëve të mbrojtjes dhe sigurisë në hapësirat publike në çdo ndërhyrje infrastrukturore të realizuar nga bashkia. | 1 listë me elementët e sigurisë të përgatitur për çdo ndërhyrje. | Drejtoria e Planifikimit të territorit | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit, OJF të specializuara. | 6M-II-2025 – | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| II.1.8. Takime informuese me vajza, të reja dhe gra në kuadër të zbatimit të Rezolutës 1325. | 15 takime (5 në vit) | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | OJF të specializuara, . | 6M-II-2025 – 6M-II-2028 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| II.1.9. Takime informuese me nxënëset dhe nxënësit mbi radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. | 15 takime (5 në vit) | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | OJF të specializuara. | 6M-II-2025 – 6M-II-2028 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| II.1.10. Trajnim i përbashkët i MKR, GTN dhe KVSP mbi trajtimin e rasteve të ndryshme të dhunës në hapësirat publike e private. | 1 trajnim i realizuar. | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | MKR, GTN, KVSP, OJF të specializuara. | 6M-I-2026 – 6M-II-2028 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| II.1.11. Ofrimi i shërbimeve mbështetëse dhe koordinuese për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. | 1 KVDHF me kohë të plotë dedikuar për menaxhimin e rasteve. Numri i rasteve të menaxhuara nga bashkia çdo vit. | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | MKR, OJF të specializuara, organizatat ndërkombëtare. | 6M-II-2025 – 6M-II-2028 | 3 | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |

| | | | | | | |
|--|--|--|---------------------------------|-------------------------------|--|---|
| II.1.12. Organizimi i mbledhjeve të rregullta të GTN dhe diskutimi mbi menaxhimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar. | 12 mbledhje të realizuara (4 çdo vit). | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | GTN, OJF të specializuara. | 6M-II-2025 – 6M-II-2028 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| II.1.13. Mbledhja në mënyrë sistematike dhe regjistrimi i të dhënave për rastet e menaxhuara në sistemin REVALB. | Sistemi REVALB i plotësuar dhe përditësuar. | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | MKR, OJF të specializuara.. | 6M-II-2025 – 6M-II-2028 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| II.1.14.. Ofrimi i shërbimit të kujdesit për fëmijët (çerdhe/kopshte) për nënat me UM, me gjysmë pagese, për gjithë kohëzgjatjen e UM. | Nr. i fëmijëve që përfitojnë këtë shërbim falas me gjysmë pagese çdo vit. | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | ZVAP, OJF të specializuara. | 6M-II-2025 – 6M-II-2028 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| II.1.15. Mbështetje dhe këshillim në familje për të iniciuar procesin e riintegrit të viktimave/të mbijetuarave të DHBGJ | Numri i takimeve me familjarë, telefonatave, këshillimeve pranë familjes, mbështetjes për punësim për anëtarë të familjes, ndihmë mjekësore për anëtarë të familje, etj. | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | MKR, OJF të specializuara. | 6M-II-2025 – 6M-II-2028 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| II.1.16. Sigurimi i mjeteve mësimore përfshirë librat, fletoret, çantat dhe mjetet e nevojshme shkollore (për viktimat minorene apo fëmijë e viktimave të DHBGJ) | Nr. i fëmijëve apo viktimave minorene të mbështetur në këtë shërbim | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | MKR, OJF të specializuara. | 6M-II-2025 – 6M-II-2028 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |
| II.1.17. Ofrimi i trajnimeve për punësim - Cikël trajnimi për punësim | Nr. I viktimave/të mbijetuarave që përfitojnë nga cikli i trajnimeve për punësim | Drejtoria Financës Shërbimi Social dhe Arsimit | MKR, ZVP, OJF të specializuara. | 6M-II-2025 – 6M-II-2028 | | KBGJ në nivel bashkie dhe KBGJMS në nivel KB. |

